



BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE NË SLOVAKI VITI AKADEMIK 2022-2023

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë në fushën e arsimit, qeveria sllovaqe ofron bursa studimi universitare në nivelin bachelor/master për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2022-2023 sipas fushave të studimit në vijim:

1. Trajnimi i mësuesve dhe shkencat e edukimit;
2. Ekonomi dhe menaxhim;
3. Ekologji dhe shkenca mjedisore;
4. Bioteknologji;
5. Agrikulturë dhe peizazh;
6. Shkenca dhe teknologjia e drurit;
7. Pyjëtari;
8. Arkitekturë dhe urbanistikë;
9. Inxhinieri mekanike;
10. Inxhinieri civile;
11. Kibernetikë;
12. Inxhinieri elektrike;
13. Inxhinieri kimike dhe teknologjitë;
14. Shkenca ushqimore;
15. Transport;
16. Nxjerrja dhe përpunimi i burimeve natyrore;
17. Mjekësi e përgjithshme;
18. Shëndeti publik.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të regjistrohen në faqen zyrtare të web-it <https://www.vladnestipendia.sk/en/> sipas kritereve të vendosura nga pala sllovaqe, si dhe duhet të dërgojnë detyrimisht me postë në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentet e mëposhtme **brenda datës 15 maj 2022:**

Për programe studimi Bachelor:

1. Kërkesën për studime, duke specifikuar programin e studimit, në të cilin kandidati dëshiron të studiojë sipas fushave të mësipërme. Në kërkesë të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni;

2. Vërtetimin e notave për dy vitet e para dhe të semestrit të parë të vitit të tretë të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në Tiranë;
3. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
4. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
5. 4 (katër) fotografi dokumenti.

Për programe studimi universitare Master:

1. Kërkesën për studime universitare *Master*, duke specifikuar programin e studimit, në të cilin kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë (Bachelor) dhe listën e notave;
3. CV-në, në të cilën të pasqyrohen të dhëna për nivelet e studimit dhe të dhëna të tjera për punësimin nëse ka;
4. Dy letra rekomandimi;
5. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
6. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
7. 4 (katër) fotografi dokumenti.

Theksojmë se me postë duhet të dërgohen kopjet e noterizuara të dokumentacionit të kërkuar me qëllim verifikimin e autenticitetit të tyre, si dhe të përfshihet edhe kopja e printuar e formularit të aplikimit. Në rast se kandidatët do të aplikojnë vetëm online ose vetëm me dokumente në MAS pa procedurën e aplikimit online do të skualifikohen dhe nuk do të jenë pjesë e vlerësimit. Në përfundim të vlerësimit të dosjeve tuaja në rast kontestimi, jeni të lutur të paraqisni ankesën tuaj me shkrim të firmosur pranë MAS.

Kushtet për përfitim të bursës, për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, përshkrimin e detajuar të programeve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Sllovakisë:

<https://www.minedu.sk/scholarships-of-the-government-of-the-slovak-republic>